

**KOMENTET E KRYETARIT TE PREZENCËS SË OSBE, AMBASADORI EUGEN
WOLLFARTH, PËR MEDIAN**

15 Prill 2013

Pyetje: Ka një aksion politik sa i përket KQZ-së.

Ambasadori Wollfarth: Ajo çka është më e rëndësishmja është shteti i së drejtës. Sot, në parlament vazhdon diskutimi. Ende nuk është marrë asnjë vendim dhe është tejet e rëndësishme që të ketë dialog midis partive politike dhe të mos humbasë kurrë vëmendja nga shteti ligjor. Unë do të bashkohem me ata që bëjnë thirrje për diskutimin e situatës.

Nuk ka dyshim që KQZ-ja aktuale është aty ku duhet dhe se është zgjedhur siç duhet, por ndërkohë që ka zhvillime, nevojitet më shumë dialog dhe ky dialogu duhet zhvilluar mes partive politike. Parlamenti është, sigurisht, një vend i mirë për këtë.

Pyetje: Mesa duket, Parlamenti do të votojë sot ...

Ambasadori Wollfarth: Besoj se e thashë gjithçka që mund të thuhet. Ajo që mua më intereson është shteti i së drejtës. Le të shohim se çfarë do të bëjnë politikanët shqiptarë.